

VENDIM
Nr. 647, datë 19.9.2012

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 371.41 M², NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, QENDRËS “PROTIK”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 901 e vijues të Kodit Civil, të nenit 4 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim, pa shpërblim, të sipërfaqes prej 371.41 m², në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, qendrës “PROTIK”, Tiranë, për një afat prej 5 (pesë) vitesh, sipas planimetrisë dhe planvendosjes të paraqitur në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Autorizohet Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit që të lidhë aktmarrëveshjen përkatëse me qendrën “PROTIK”, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Ngarkohet Kryeministria dhe Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha